



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt. 21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05nr.350/02-236300/23 dt. 26.12.2023, të kërkuësve/pronarëve Ajshe Zhushi, Shyqri Maliqi (qirambajtje 99vite) dhe "Royal" SH.P.K. (qirambajtje 99vite), me investitori "Royal" SH.P.K. me adresë "Mati 1", rr. "Muharrem Fejza", Prishtinë, me certifikatë të biznesit nr. 810809733, me pronar Teuta Kryeziu nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste me ndërtesat për Fazën I. "A", "B", "C" dhe Fazën II. "D", "E" dhe "F", në kuadër të Bllokut urban "C3" të Planit Rregullues "Prishtina e re Zona Perendim" dhe PZHU-së në Prishtinë, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit-"zgjidhjes urbane" të prezantuar, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë të rregullt administrative për vendosjen e çështjes administrative me datë 19.03.2025, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuësve / pronarëve Ajshe Zhushi, Shyqri Maliqi (qirambajtje 99vite) dhe "Royal" SHPK (qirambajtje 99vite), me investitorit "Royal" SH.P.K., me certifikatë të biznesit 810809733, me pronare Teuta Kryeziu nga Prishtina, sipas kërkesës 05nr.350/02-236300/23 dt. 26.12.2023, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste siq janë: Faza I. Ndërtesat "A", me etazhitet "3B+S+P+1, ndërtesa "B", me etazhitet 3B+S+P+13, ndërtesat "C", me etazhitet 3B+S+P+14 dhe Faza II. ndërtesa "D", me etazhitet 3B+S+P+14", "E", me etazhitet 3B+S+P+13 dhe "F", me etazhitet 3B+S+P+1, në kuadër të Bllokut urban "C3" të Planit Rregullues "Prishtina e re Zona Perendim" në Prishtinë, konkretisht në parcelat kadastrale nr. 1760-1; 1760-2; 1760-3; 1760-4; 1760-6; 1760-8; 1760-9; 1760-10; 1761-4; 1761-5; 1789-2 dhe 1789-3 ZK Prishtine, dhe përmes këmbimit pjesë të parcelave kadastrale nr. 1789-6 dhe 1947-1 ZK Prishtinë në pronësi të Komunës së Prishtinës, me parcelat kadastrale nr. 395-1, 396-2; 397-1, 398-1, 399-1 dhe 454-5 ZK Zllatar, me pronar "Royal" SH.P.K., sipas projekt propozimit konceptual dhe Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane".

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e re Zona Perendim", miratuar me Vendimin 01 Nr. 035-186850 dt. 02.10.2013, e Kuvendit Komunal të Prishtinës, ku sipas këtij plani kjo zonë është e planifikuar me destinim për "Banim dhe Afarizëm",

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit-parcelës kadastrale, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:

- nr. 1760-1,.....	S=138 m ²	"Royal" SH.P.K. (Qirambajtje 99vite).....	"Arë e klasës 3"
- nr. 1760-2,.....	S= 120 m ²	"Royal" SH.P.K. (Qirambajtje 99vite).....	"Arë e klasës 3"
- nr. 1760-3,.....	S= 120 m ²	"Royal" SH.P.K. (Qirambajtje 99vite).....	"Arë e klasës 3"
- nr. 1760-4,.....	S=396 m ²	"Royal" SH.P.K. (Qirambajtje 99vite).....	"Arë e klasës3"
- nr. 1760-6,.....	S= 288 m ²	"Royal" SH.P.K. (Qirambajtje 99vite).....	"Arë e klasës 3"
- nr. 1760-8,.....	S=211 m ²	"Royal" SH.P.K. (Qirambajtje 99vite).....	"Arë e klasës 3"
- nr. 1760-9,.....	S= 197 m ²	Shyqri Maliqi. (Qirambajtje 99vite).....	"Arë e klasës 3"
- nr.1760-10,.....	S= 339 m ²	"Royal" SH.P.K (Qirambajtje 99vite).....	"Arë e klasës 3"

- nr. 1761-4,.....S= 313 m² Shyqri Maliqi. (Qirambajtje 99vite)....."Are e klases 3"
 - nr. 1761-5,..... S= 556 m² "Royal" SH.P.K. (Qirambajtje 99vite)....."Arë e klases 3";
 - nr. 1789-2,..... S= 4278 m²; Ajshe Zhushi; "Pemishte e klases 2"
 - nr. 1789-3,..... S= 1454 m²; Ajshe Zhushi ; "Pemishte e klases 2"
- Totali i sipërfaqës S=8410 m²

Pronat e planifikuara për këmbim të ndodhura në unazë dhe vazhdimin e rrugës "A":

- nr. 395-1,S=402 m²(nga totali S=440 m²)..... "Royal" SH.P.K....."Livadh i klases 3"
- nr. 396-2,S=577 m².....(nga totali S=585 m²)..... "Royal" SH.P.K....."Mal i klases 3"
- nr. 397-1,S=391 m²..... "Royal" SH.P.K....."Mal i klases 3"
- nr. 398-1,S= 43 m².....(nga totali S= 46 m²) "Royal" SH.P.K..... "Livadh i klases 3"
- nr. 399-1,S= 192 m².....(nga totali S=460 m²)..... "Royal" SH.P.K..... "Livadh i klases 3"
- nr. 454-5, S= 1205 m²..... "Royal" SH.P.K..... "Livadh i klases 3"

Totali i sipërfaqës S=2810 m²

Prona e Komunës që ndodhet brenda bllokut "C3":

- nr. 1789-6,S=655+882=1537 m².....(nga totali S=3921 m²).....Komuna e Prishtinës;
- nr. 1947-1,.....S=252m².....(nga totali S=3089 m²).....P.SH. Rrugët;

Totali i sipërfaqës S=1789 m² që trajtohet me këto kushte;

- E drejta pronësore - juridike e parcelave kadastrale të lartcekura, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1760-10; 1761-5; 1760-6; 1760-1; 1760-8; 1760-3; 1760-2; 1760-4; 1760-9; 1761-4 janë të ndërtuara ndërtesa individuale banimore me etazhitet B+P+1, kurse parcelat kadastrale nr. 1789-2 dhe 1789-3 ZK Prishtine, janë të lira, nuk ka ndërtesa të ndërtuar;
- Në kuadër të pjesës së Blloku urban "C3", konkretisht në brendësi të parcelave të trajtuara përfshihet (pjesërisht) edhe parcela kadastrale nr. 1789-6 dhe 1947-1 ZK Prishtine me pronar KK Prishtinës që pjesërisht trajtohen në zgjedhje urbane me sipërfaqe S= 1433 m² dhe kjo sipërfaqe do të kembehen me prona private;
- Terreni i lokacionit në bllokun urban "C3" ka pjerrtësi përgjatë rrugës egzistuese "Holger Petersen" por edhe e planifikuar për zgjerim kah drejtimi veri jug me disnivel H=8.0m' apo 9.0 % rënie ndërsa në bllokun urban C3 ka pjerrtësi me disnivel H=5.5 m' apo 9.2% në të njëjtin drejtim;
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale të lartcekur është përmes rrugës lokale rruga "Helger Petersen" e cila rrugë është edhe rrugë e planifikuar e planit rregullues;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50m" ka ndërtesa ekzistuese si: ndërtesa shumë banesore, shtëpi individuale banimore, ndërtesa ndihmese, etj;

IV. Projekti konceptual – "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, e analizuar, studiuar dhe trajtuar me këto kushte ndërtimore, është konceptuar në dy grupacione/faza të realizimit: "Faza e I-rë" dhe "Faza e II-të", si në vijim:

a) "Faza e I-rë" në kuadër të kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, me Ndërtesat "A", "B" dhe "C", të planifikuara në parcelat kadastrale nr. 1789-2 dhe 1789-3 ZK Prishtine, me sipërfaqe të trajtuar brenda vijës rregulluese **S=3493 m²**, bazuar në manualin e ndarjes/bashkimit dhe

b) "Faza e II-të" në kuadër të kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, me Ndërtesat "D", "E" dhe "F", do të trajtojë pjesët e parcelave kadastrale nr. 1760-1; 1760-2; 1760-3; 1760-4; 1760-6; 1760-8; 1760-9; 1760-10; 1761-4; 1761-5; ZK Prishtine, dhe përmes këmbimit pjesë të parcelave kadastrale nr. 1789-6 dhe 1947-1 ZK Prishtinë në pronësi të Komunës së Prishtinës, me sipërfaqe të trajtuar brenda vijës rregulluese **S=3797 m²**, bazuar në manualin e ndarjes.

Sipërfaqja e përgjithshme e pjesës së bllokut urban "C3"- parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulluese, e trajtuar me këto kushte ndërtimore, është **S=7290 m²** (bazuar në sipërfaqet e përcaktuara në certifikatën e njësisë kadastrale, projektin konceptual – "zgjidhja urbane" dhe në manualin e ndarjes).

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të parcelës ndërtimore të kompleksit, e përfshirë në kuadër të bllokut urban "C3-1" dhe "C3-2", të Planit Rregullues "Prishtina e re zona Perendim" në Prishtinë, përcaktohen duke konsultuar, analizuar, si dhe mbështetur në dokumentet e planifikimit hapësinor, projekt propozimin e prezantuar, gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe rregullativën ligjore në fuqi, dhe ato janë:

- Parcela ndërtimore, organizimi, gabariti, pozicionimi dhe etazhiteti i ndërtesës, qasja në kompleks si dhe raporti i ndërtesës me vijën rregulluese dhe ndërtimore, distancat në mes ndërtesave dhe nga kufiri i parcelës ndërtimore, rrugët dhe vendparkimet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të planifikohen sipas kriterëve të planit rregullues urban dhe kriterëve të përcaktuara në pikat e këtij paragrafi, duke u bazuar në "Plani i lokacionit-“zgjidhja urbane”, si dhe "Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Prishtina e re zona Perendim", në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

- Parcela kadastrale me sipërfaqen e trajtuar, në pjesën e bllokut "C3", të Planit Rregullues "Prishtina e re zona Perendim", për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, që përfshihet në ndërtim-parcelë ndërtimore, e trajtuar **brenda vijës rregulluese**, është:

1760-1.... S= 2 m²

1760-2.... S= 16 m²

1760-3.... S= 111 m²

1760-4.... S= 256 m²

1760-6.... S= 288 m²

1760-8.... S= 103 m²

1760-9.... S= 197 m²

1760-10.... S= 189 m²

1761-4.... S= 313 m²

1761-5.... S= 533 m²

1789-2 S= 2682 m²

1789-3 S= 811 m²

Prona e planifikuar për këmbim:

1789-6.... S= 1537 m²

1947-1.... S= 252 m²

Sipërfaqe e përgjithshme e parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulluese, është S= 7,290m²;

- Parcela kadastrale me sipërfaqen e trajtuar, në pjesën e bllokut "C3", të Planit Rregullues "Prishtina e re zona Perendim", për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, që përfshihet në ndërtim-parcelë ndërtimore, e trajtuar **jashtë vijës rregulluese**, është:

1760-1.... S= 136 m²/ për shpronësim;

1760-2.... S= 104 m²/ për shpronësim;

1760-3.... S= 9 m²/ për shpronësim;

1760-4.... S=141 m²/ për shpronësim;

1760-6.... S= 0 m²/

1760-8.... S= 108 m²/ për shpronësim;

1760-9.... S= 0 m²/

1760-10.... S= 150 m²/ për shpronësim;

1761-4.... S= 0 m²/

1761-5.... S= 23 m² / për shpronësim;

1789-2 S= 1596 m²/ nga kjo 1585 m2 janë shpronësim ndërsa 11m2 për këmbim;

1789-3 S= 644 m² / për këmbim

395-1, S=402m2 / për këmbim

396-2, S=577m2 / për këmbim

397-1,..... S=391m2 / për këmbim

398-1,.....S=43 m2 / për këmbim

399-1,S=192m2 / për këmbim

454-5,S=1205 m2 / për këmbim

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave jashtë vijës rregulluese S= 5721 m2 të planifikuara si në vijim:

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave jashtë vijës rregulluese, e trajtuar sipas Vendimit 14-464/01-97987/22 dt. 05.05.2022 për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është.....S=136+104+9+141+108+150+23+1585=2256 m2 të cilat kompenzohen me koeficient ndërtimor;

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave jashtë vijës rregulluese, e trajtuar sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës është
S=11+644+402+577+391+43+192+1205=3465 m², të planifikuara për këmbim.

• Me kushtet ndërtimore në kuadër të kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste, në kuadër të Bllokut urban "C3, të Planit Rregullues "Prishtina e re zona Perendim", planifikohet të ndërtohet kompleksi me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, të organizuar në hyrje, me sipërfaqe ndërtimore mbi tokë dhe nën tokë, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Ndërtesa shumë banesore dhe afariste "A", "B", "C", "D", "E" dhe "F"

Faza e I-rë - Ndërtesa "A", "B" dhe "C"

- Ndërtesa "A",

S=2162.8 m² / 554.7 m², mbi tokë + 1608.1 m², nën tokë /,

Etazhiteti: 3B+S+P+1;

- Ndërtesa "B",

S=10024.8 m² / 7595.6 m², mbi tokë + 2429.2 m², nën tokë /,

Etazhiteti: 3B+S+P+13;

- Ndërtesa "C",

S=10061.3 m² / 7857.0 m², mbi tokë + 2204.3 m², nën tokë /,

Etazhiteti: 3B+S+P+14;

Sipërfaqja e përgjithshme për Fazën I.: S=22248.94 m² /16007.5 m², mbi tokë+6241.68 m², nën tokë /,

Faza e II-të – Ndërtesa "D", "E" dhe "F"

- Ndërtesa "D",

S=10256.5 m² / 7785.0 m², mbi tokë + 2328.3 m², nën tokë /,

Etazhiteti: 3B+S+P+14;

- Ndërtesa "E",

S=10459.9 m² / 7154.05 m², mbi tokë + 2502.7 m², nën tokë /,

Etazhiteti: 3B+S+P+13;

- Ndërtesa "F",

S=2162.8 m² / 554.7 m², mbi tokë + 1608.1 m², nën tokë /,

Etazhiteti: 3B+S+P+1;

Sipërfaqja e përgjithshme për Fazën II.: S=21932.82 m²/15493.7 m², mbi tokë+6439.12 m², nën tokë /,

Sipërfaqja e përgjithshme për Fazën I. dhe Fazën II.: S=44,181.76 m²/31501.0m² mbi tokë+12680.8 m² nën tokë.

• Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin e përdhese ose suteranit është max. 0.40 (40 %), dhe për etazhat tjera 30% dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:

S= 7,290m² x 0.4 = 2916.0 m² /lejuar sipas planit rregullues /,

S=2916.0 m²/ sipas projekt propozimit, për përdhesë dhe suteran /;

S=7,290m² x0.3=2187.0m²/lejuar sipas planit rregullues /,

S=2176.4 m²/ sipas projekt propozimit, për etazhat tjera /;

• Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHPN), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin e bodrumit, është max. 0.60 (60 %), sipas planit rregullues dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:

S=7,290m² x 0.60 = 4374.0 m² / lejuar sipas planit rregullues dhe Vendimit të Kryetarit /;

S=3740.9 / sipas projekt propozimit /;

• Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), sipas planit rregullues dhe bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:

S=7,290m² x 0.4 = 2916.0 m² / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit /;

S=7,290 m²x 0.3= 2187m²/me aplikimin e kulmit të gjelbërt lejuar sipas Vendimit të Kryetarit/;

S=2187m² /sipas projekt propozimit 30% mbi tokë dhe aplikimi i kulmit të gjelbërt;

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) për zonën “C3”, të tërësisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, është max. 3.3. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës-**suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:

$$S = 7,290 \text{ m}^2 \times 3.3 = 24,057.0 \text{ m}^2 \text{ /lejuar sipas planit rregullues /,$$

S=31501.0 m² / sipas projekt propozimit duke përfshirë edhe shpronësimin

- Me aplikimin e Vendimit 14-464/01-97987/22 dt. 05.05.2022 për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin/shpronësimin e pronës private, të planifikuar për interes publik, me koeficient të ndërtimit, do të mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 35 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, për realizimin e rrugës “A” dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe, përcaktuar në përqindje (%) është $S = 2256 / 7290 \times 100 = 30.9\%$. Sipas këtij kalkulimi, pronarët dhe investitori, për sipërfaqen e theksuar, do të kompensohen me sipërfaqen ndërtimore, llogaritur me koeficient të ndërtimit 3.3, $S = 2256 \times 3.3 = 7444.8 \text{ m}^2$, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore, e lejuar, do të jetë
- $$\underline{S = 24,057.0 \text{ m}^2 + 7444.8 = 31501.8 \text{ m}^2.}$$
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
 - Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të kompleksit, të jetë për banim shumë banesor dhe afarizëm, dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
 - Etazhiteti maksimal për bllokun urban “C3”, të tërësisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, është max P+14, ku i njëjti etazhiteti mund të ndryshojë me aplikimin e Vendimit 14-464/01-97987/22 dt. 05.05.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private për interes publik me koeficient të ndërtimit;
 - Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca në mes të objekteve (banim kolektiv dhe ndërtesa afariste) është 1.0H, për ndriçim primar ose së paku 7m’ për ndiçim sekondar, apo 0.5H nga kufiri i parcelës;
 - Çdo objekt ndërtimor i planifikuar duhet të jetë i vendosur me fasadën e përparme në vijën ndërtimore, respektivisht përbrenda hapësirës së kufizuar me vijën ndërtimore;
 - Ngritja e nivelit të përdhësës së ndërtesës nga niveli i terrenit - trotuarit të ndërtesës, lejohet të jetë max.1.20 m, ndërsa, për ndërtesa që në përdhese kanë tregti apo shërbime afariste, kuota e përdhësës mund të jetë më e madhe se kuota e trotuarit për (max) 0.30 m;
 - Qasja në kompleksin me ndërtesa shumë banesore dhe afariste të jetë nga rruga e planifikuara sipas planit rregullues urban dhe Planit të situacionit - “zgjidhja urbane”;
 - Për çdo njësi banesore të planifikohet 1 (një) vend parkim, kurse për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen vend parkimet, ku për çdo 40 m² (neto)/1 vend parkim;
 - Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vendparkimet e jashtme dhe mjetete transportit alternativ (biçikleta, trotinet, e-scooter, etj), rrugë të brendshme të kompleksit, mobiliari urban, kënde të lodrave për fëmijë e të ngjashme, si dhe shtigjet dhe trotualet;
 - Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave e cila duhet të jetë e mbyllur;
 - Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
 - Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuar në kriteret dhe parametrat urban të Planit Rregullues “Prishtina e Re — Zona Perëndim”.

VI. Ndarja / parcelimi i parcelave kadastrale nr. 1760-1; 1760-2; 1760-3; 1760-4; 1760-8; 1760-10; 1761-5; 1789-2 dhe 1789-3 ZK Prishtine, do të realizohet bazuar në Planin e situacionit-’ zgjidhja urbane”, Situacionin e parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga plani rregullues, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualin e ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar Driton Haziri nga Prishtina, me licencë nr.177.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - “zgjidhja urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin kordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes, punuar nga

gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në, Planin e situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREFO 1", punuar nga kjo drejtori dhe Manualin e ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr. 1789-6, ZK Prishtinë, me sipërfaqe $S=1537 \text{ m}^2$ (nga totali $S=3826.5 \text{ m}^2$), dhe parcelës nr. 1947-1, ZK Prishtinë, me sipërfaqe $S=252 \text{ m}^2$ (nga totali $S=3089 \text{ m}^2$), në pronësi/posedim të P.SH. Rugët KK Prishtinë, në total $S=1537+252=1789 \text{ m}^2$, e shtrirë brenda vijës rregulluese të bllokut urban "C3", e Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", është propozuar të bëhet nga pronari dhe investitori, ku nga totali i 1789 m^2 , 655 m^2 prej tyre është propozuar të këmbëhen me pjesët e parcelave kadastrale nr. 1789-3 ZK Prishtinë, me pronar Ajshe Zhuzhi, me sipërfaqe $S=644 \text{ m}^2$, dhe nr.1789-2 ZK Prishtinë, me pronaren e njëjtë Ajshe Zhuzhi, me sipërfaqe $S=11 \text{ m}^2$, të ndodhura jashtë vijës rregulluese të bllokut urban e që në total është $S=644+11=655 \text{ m}^2$, kurse sipërfaqja e mbetur brenda bllokut për kambi $S=1789 \text{ m}^2-655 \text{ m}^2=1134 \text{ m}^2$, përkatësisht $S=1134 \text{ m}^2$ është propozuar të këmbëhen me pjesët e parcelave kadastrale nr. 395-1, ZK Zllatar, me pronar "Royal" SH.P.K., me sipërfaqe $S=402 \text{ m}^2$, nr. 396-2, ZK Zllatar, me pronar "Royal" SH.P.K., me sipërfaqe $S=577 \text{ m}^2$, nr.397-1, ZK Zllatar, me pronar "Royal" SH.P.K., me sipërfaqe $S=391 \text{ m}^2$, nr.398-1, ZK Zllatar, me pronar "Royal" SH.P.K., me sipërfaqe $S=43 \text{ m}^2$, nr.399-1 ZK Zllatar, me pronar "Royal" SH.P.K., me sipërfaqe $S=192 \text{ m}^2$, dhe nr. 454-5, ZK Zllatar me pronar "Royal" SH.P.K., me sipërfaqe $S=1205 \text{ m}^2$ të ndodhura në "unazën e planifikuar dhe vazhdimin e rrugës "A", me sipërfaqe totale $S=402+577+391+43+192+1205=2810 \text{ m}^2$, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për këmbimin e parcelave të lartcekura, sipas Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore dhe manualit, punuar nga gjeodeti i licencuar Driton Haziri nga Prishtina, me licencë nr.177. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e këmbimit duhet të realizohet, para aplikimit për leje ndërtimore për relizimin e Fazës II. të kompleksit, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarit dhe investitorit, duke u bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planin Rregullues në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, detyron Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë kushtet ndërtimore - revokimin e tyre.

VIII. Bashkimi i parcelave kadastrale, që ndodhen brenda bllokut "C3" nr. 1760-1; 1760-2; 1760-3; 1760-4; 1760-6; 1760-8; 1760-9; 1760-10; 1761-4; 1761-5; 1789-2 dhe 1789-3 ZK Prishtinë, dhe me pjesë të pronave pas këmbimit nr. 1789-6 dhe 1947-1 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas Parcelës ndërtimore, bazuar në Planin e situacionit - "zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planin Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manualit të bashkimit, punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj drejtorja jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planin Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manualit për bashkim. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, bazuar në kushtet ndërtimore, me kërkesë të pronarëve & investitorit, bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, punuar nga gjeometri i drejtorisë dhe manualit për bashkimin punuar nga gjeometri i licencuar Driton Haziri nga Prishtina, me licencë nr.177, e të cilët janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IX. Kompensimi / shpronësimi me koeficient ndërtimi i pjesës së parcelës kadastrale nr. 1760-1, me sipërfaqe $S=136 \text{ m}^2$, nr. 1760-2, me sipërfaqe $S=104 \text{ m}^2$, nr.1760-3, me sipërfaqe $S=9 \text{ m}^2$, nr.1760-4, me sipërfaqe $S=141 \text{ m}^2$, nr. 1760-8.... $S=108 \text{ m}^2$, nr. 1760-10, me sipërfaqe $S=150 \text{ m}^2$, nr. 1761-5, me sipërfaqe

$S = 23 \text{ m}^2$ dhe nr. 1789-2 ZK Prishtinë, me sipërfaqe $S = 1585 \text{ m}^2$ janë propozuara për shpronësim, me sipërfaqe të përgjithshme $S = 136 + 104 + 9 + 141 + 108 + 150 + 23 + 1585 \text{ m}^2 = 2256 \text{ m}^2$, e përfshirë në hapësirë publike të planifikuar-rrugë, kryesisht nga rruga "A", do të realizohet sipas Marrëveshjes e lidhur në mes të pronarëve të parcelave dhe Drejtorisë së Pronës bazuar në Vendimit 14-464/01-97987/22 dt. 05.05.2022 për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01 Nr. 400-660 dt. 26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ku mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 35 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, për realizimin e rrugës "A" dhe sipas kësaj kalkulimi i shprehur në përqindje është si në vijim $S = 2256 / 7290 \times 100 = 30.9\%$, andaj sipërfaqja $S = 2256 \text{ m}^2$ do të kompensohet me koeficient të ndërtimit 3.3, dhe atë me sipërfaqe ndërtimore $S = 2256 \times 3.3 = 7444.8 \text{ m}^2$.

Procedura e shpronësimit do të realizohet, pas ndarjes së parcelave kadastrale dhe para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Pronës së Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, punuar nga gjeometri i drejtorisë dhe manualit punuar nga gjeometri i licencuar, të cilët janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë vendimin e kushteve ndërtimore, gjegjësisht revokimin e tyre.

X. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
 - Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
 - Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
 - Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
 - Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).
- Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohësja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

XI. Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, "Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", bazuar në "Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dymëve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;

- Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

